



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 45 datë 07.05.2026

PËR DHËNIE TITULLI “ QYTETAR NDERI ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.7 datë 08.01.2026 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë,

VENDOSI:

1 – T”i japë titullin “ Qytetar Nderi ”

Z. Përparim Zija Kabo me motivacionin :

“ Për kontribut të shquar të mendimit akademik, për vlerat e larta studimore në fushën filozofike, për aftësi të jashtëzakonshme për promovimin me dinjitet të vlerave të qytetërisë shqiptare, për përkushtimin. profesionalizmin dhe humanizmin që e karakterizon ” .

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI

